



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.106/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë - dega në Komunën e Ferizajt, për shkak të vendosjes së posterit në shtyllën e ndriçimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet e bazuar**, ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë - dega në Komunën e Ferizajt, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 2,000.00 euro (dymijë), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.09.2019, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me fotografi të printuara. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 27.09.2019, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të ngjitura në hapësira publike, në shtylla të ndriçimit publik. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterat e kandidatit të tyre për deputet në shtyllat e ndriçimit publik. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të mirësjelljes për subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjën në ankesë, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 27.09.2019, ka theksuar se në kushtet dhe rrethanat të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore dhe duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur ashtu siq kërkohet në dispozitat ligjore, të krijojnë hapsira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore dhe sipas tyre vendosja e posterave në një shtyllë elektrike nuk duhet të trajtohet si shkelje. Subjekti politik në përgjigjiën e tij pretendon se shtyllat elektrike, pavarësisht faktit që është pronë publike tek ne në Kosovë janë përdorur në mungesë të hapsirave të dedikuara për këtë. Pavarësisht kësaj subjekti politik LDK njofton se ka ndërrmar masat e duhura dhe ka evituar shkeljen e pretenduar nga kandidati në fjalë, duke larguar fotot e kandidatit për deputet, dhe menjëherë pas pranimi të ankesës i kemi ndërmarr veprimet përmirësuese, pra nga këto veprime është evituar shkelja sipas

pretendimeve në ankesë. Përgjigjes në ankesë si provë i kanë bashkangjitur disa fotografi nga vendi ku janë larguar posterat e kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Më fotografitë e ofruara si provë nga paraqitësi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Ferizajt, janë vendosur në shtylla të ndriçimit publike në afërsi të Shkollës “Tefik Çanga”, në Rr. ”Besim Rexhepi”, në Komunën e Ferizajt, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterët e kandidatit për deputet nga LDK-ja, janë vendosur në hapësira publike - në shtylla të ndriçimit publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur, në ankesë dhe ta përmirësojnë shkeljen e bërë, ashtu që në përgjigjen në ankesë, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin se në kushtet dhe rrethanat në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, dhe duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, të njëjtit i kanë vendosur atë ku pretendohet në ankesë.

PZAP-i, me rastin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, mori parasysh pretendimet subjektit politik LDK, të cilat pretendime i vlerësoi si të pa ndikim për të vendosur ndryshe. Paneli vlerësoi se subjekti politik LDK, brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, ka ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në shqiptimin e gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund të shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 10,000.00 euro, mirëpo

siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik LDK, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në shqiptimin e gjobës.

Paneli, me këtë vendim ka për qëllim që të ndikon te subjekti politik LDK, që mos të përsërit veprimet e kësaj natyre në të ardhmen, andaj nga arsyet e theksuara me lartë e në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr. 106/2019 më datën 30.09.2019



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.